

**Njoftim për përqendrim me të cilin SoftwareOne Holding AG, Zvicër do të fitojë
kontroll mbi Crayon Group Holding ASA, Norvegji
(lënda nr. 08-84/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 15.05.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga ana e SoftwareOne Holding AG, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e listuar në bursë, e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Zvicrës, me seli të regjistruar në adresën Riedenmatt 4, CH-6370 Stans, Zvicër, mbi Crayon Group Holding ASA, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e listuar në bursë dhe e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Norvegjisë, me seli të regjistruar në adresën Gallehaug Torg nr. 5, 0484 Oslo, Norvegji, përmes fitimit të shumicës së aksioneve në Crayon.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

SoftwareOne është furnizues global i zgjidhjeve softuerike dhe cloud, i cili ofron një paketë të plotë shërbimesh, përfshirë ofrimin e mbështetjes për klientët në sigurimin dhe optimizimin e licencave softuerike dhe cloud, si dhe shërbime të lidhura të implementimit dhe mbështetjes, me qëllim që t’u ndihmojë klientëve të tij në përballimin e kompleksitetit të cloud-it, të dhënave dhe inteligjencës artificiale në kontekstin e transformimit digjital.

Grupi SoftwareOne nuk ka shoqëri të varura, filiale apo përfaqësi të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Crayon ofron shërbime për planifikim, menaxhim dhe inovacion të zgjidhjeve IT. Crayon operon në nivel global, në 46 shtete, me një ekip prej më shumë se 4.000 profesionistësh. Crayon është i ndarë në mënyrë të brendshme në këto fusha afariste: Software & Cloud Direct dhe Software & Cloud Channel, Software & Cloud Economy dhe Konsulencë.

Në Maqedoninë e Veriut, Crayon ka qendër pranishëm në vitin 2024 përmes shoqërisë së varur në pronësi të plotë – CREYON MAQEDONIA SHPKNJ SHKUP (me NUAS 7296843, seli e regjistruar në rr. Mirçe Acev nr.2-kati 3/Shkup - Qendër, dhe me veprimtari prioritare të regjistruar 62.100 - Programim kompjuterik).

Sipas parashtruesit të njoftimit, si tregje relevante të mallrave për qëllime të vlerësimit të këtij përqendrimi mund të përcaktohen: tregu për shpërndarje/(ri)shitje të produkteve IT, përfshirë softuerin, dhe tregu për ofrim të shërbimeve IT, ndërsa tregu relevant gjeografik mund të përcaktohet në nivel global.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose me

e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Shkup

20.05.2025